

VENDIM
Nr. 666, datë 2.9.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË VEPRIMTARIVE QË KONSIDEROHEN SI TË RREZIKSHME PËR MJEDISIN¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së veprimtarive që konsiderohen si të rrezikshme për mjedisin, të përcaktuara sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Lista e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, zbatohet pa cenuar detyrimet e tjera që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi. Veprimtari të rrezikshme për mjedisin konsiderohen veprimtaritë ekonomike ose profesionale që, për nga natyra e rrezikut ndaj burimeve natyrore, përmasat, teknologjia ose substancat e përdorura, paraqesin rrezik të lartë për dëme mjedisore dhe sjellin përgjegjësi mjedisore, sipas legjislacionit në fuqi, duke shkaktuar:

- a) dëme ndaj burimeve natyrore;
- b) ndotje të ujërave, tokës dhe ajrit;
- c) dëmtim të biodiversitetit dhe habitateve të mbrojtura;
- ç) rrezik për shëndetin e njeriut.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

¹ Ky vendim synon përafrimin e pjesshëm të direktivës 2004/35/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, “Për përgjegjësinë mjedisore, në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmit mjedisor” (OJ L 143, 30.4.2004, f. 56) (CELEX 32004L0035), e ndryshuar.

Shtojca 1

LISTA E VEPRIMTARIVE QË KONSIDEROHEN SI TË RREZIKSHME PËR MJEDISIN

1. Të gjitha instalimet, që pajisen me leje mjedisi të tipit A, sipas legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, me përjashtim të instalimeve ose pjesëve të instalimeve që përdoren për kërkim, zhvillim dhe testim të produkteve dhe proceseve të reja.

2. Veprimtaritë e menaxhimit të integruar të mbetjeve, përfshirë grumbullimin, transportin, rikuperimin dhe asgjësimin e mbetjeve dhe të mbetjeve të rrezikshme, përfshirë mbikëqyrjen e këtyre veprimtarive dhe kujdesin pas mbylljes, që pajisen me leje mjedisi në zbatim të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit dhe për menaxhimin e mbetjeve.

Këto veprimtari përfshijnë, ndër të tjera, funksionimin e *landfill*-eve dhe funksionimin e impianteve të incinerimit ose bashkincinerimit të mbetjeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Për qëllimet e këtij vendimi, në këtë kategori veprimtarish nuk përfshihen veprimtaritë e shpërndarjes së llumit të ujërave të ndotura nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, të trajtuara sipas standardeve të miratuara referuar legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, për qëllime bujqësore.

3. Të gjitha instalimet dhe veprimtaritë, që kanë shkarkime në ujërat sipërfaqësore dhe që pajisen me leje për shkarkimet e lëngshme në trupat ujorë sipërfaqësorë, referuar legjislacionit në fuqi për burimet ujore dhe legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit.

4. Të gjitha instalimet dhe veprimtaritë, që kanë shkarkime në ujërat nëntokësore dhe që pajisen me leje për shkarkimet e lëngshme në ujërat nëntokësore, referuar legjislacionit në fuqi për burimet ujore dhe për lejet e mjedisit.

5. Shkarkimi ose injektimi i ndotësve në ujërat sipërfaqësore ose në ujërat nëntokësore, që kërkon leje ose autorizim, referuar legjislacionit në fuqi për burimet ujore.

6. Nxjerrja e ujit dhe krijimi i rezervuarëve të ujit që kërkon leje ose autorizim, referuar legjislacionit në fuqi për burimet ujore.

7. Çdo veprimtari industriale, tregtare ose bujqësore që lidhet dhe përfshin prodhimin, përdorimin, ruajtjen, përpunimin, mbushjen, lëshimin në mjedis dhe transportin brenda vendit të substancave dhe produkteve të klasifikuara si të rrezikshme, sipas legjislacionit në fuqi për kimikatet, përkatësisht:

- a) substanca të rrezikshme;
- b) perzrierje të rrezikshme;
- c) produkte për mbrojtjen e bimëve (produkte fitosanitare), sipas legjislacionit në fuqi për produktet e mbrojtjes së bimëve dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- ç) produkte biocide, sipas legjislacionit në fuqi për produktet biocide dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

8. Veprimtaritë e transportit rrugor, hekurudhor, detar, lumor dhe ajror të mallrave të rrezikshme ose mallrave ndotëse, sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave të rrezikshme.

9. Veprimtaritë e funksionimit të instalimeve industriale që shkarkojnë substanca ndotëse në ajër dhe që pajisen me leje mjedisi, në zbatim të legjislacionit në fuqi për lejet e mjedisit, si dhe akteve nënligjore përkatëse, në lidhje me shkarkimin në ajër të substancave ndotëse.

10. Çdo veprimtari lidhur me përdorimin dhe transportin e mikroorganizmave të modifikuar gjenetikut, sipas legjislacionit në fuqi.

11. Veprimtaritë që përfshijnë lëshimin e qëllimshëm në mjedis, transportin dhe vënien në treg të organizmave të modifikuar gjenetikut, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

12. Veprimtaritë që lidhen me transportin ndërkufitar të mbetjeve, përfshirë eksportin, importin dhe tranzitin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

13. Veprimtaritë që lidhen me menaxhimin e mbetjeve nga industritë nxjerrëse, sipas legjislacionit në fuqi për sektorin minerar dhe menaxhimin e mbetjeve minerare.

14. Veprimtaritë që lidhen me kapjen, depozitimin gjeologjik të dyoksidit të karbonit (CO₂), sipas legjislacionit në fuqi.